

SHPLLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Koordinator	Reparti Ushtarak nr.6028,AIM	Tiranë	Pa afat	Po	Po	04.11.2025	10.11.2025

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Koordinator për Sigurinë
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Njësia e Cilësisë dhe Sigurisë, në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes, Reparti Ushtarak Nr.6028
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 04.11.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 10.11.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do të dërgohet në: <i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës Tiranë.</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesën;
- b) formularin e aplikimit;
- c) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- ç) diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- d) fotokopje të patentës nëse ka;
- dh) dëshmi profesioni nëse ka; e) raport mjekësor për aftësi në punë (vlefshmëria 3 muaj);
- ë) fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- f) dëshmi penaliteti;
- g) vërtetim nga gjykata;
- gj) vërtetim nga prokuroria;
- h) librezë pune;
- i) jetëshkrimin (CV);
- j) formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit)
- k) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit të plotësuar kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme sipas përshkrimit të punës;
- e) të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli sipas legjislacionit për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a) Grada/Titulli: Koordinator për Sigurinë
- b) Arsimi: I lartë universitar sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Akademi Ushtarake. Përfundimi i studimeve në një universitet të dytë përbën avantazh, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë
- c) Kualifikimi: Në fushën e lartëpërmendur.
- ç) Trajnimi: Trajnime në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.
- d) Eksperienca në Punë: Të ketë përvojë pune minimumi 10 vjet, në institucionet të sigurisë. Procese pune që lidhen me verifikimin e kërkesave ligjore dhe hartimin e raporteve. Përvoja në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë përbën avantazh. Pjesëmarrja në trajnime dhe bashkëpunime ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.
- dh) Gjuha e huaj: Njohuri të mira të gjuhës angleze.
- e) Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve kryesore të kompjuterit dhe përdorim shumë i mirë i paketës Microsoft Office.

ë) Të plotësojë kushtet për t'u pajisur me Certifikatë të Sigurisë së Personelit sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e personelit".

Përshkrimi i punës:

Koordinatori për Sigurinë siguron efikasitetin dhe përputhshmërinë e proceseve institucionale me objektivat strategjike. Ushtron funksione horizontale dhe raporton drejtpërdrejt tek Drejtori i Përgjithshëm, duke vepruar si hallkë koordinuese ndërmjet drejtorive të brendshme. Koordinatori për Sigurinë përfaqëson AIM në proceset e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional që lidhen me fushat e tij të përgjegjësisë.

Detyrat kryesore:

- Udhëheq strukturën e sigurisë dhe raporton tek drejtori i Përgjithshëm për çështje që lidhen me sigurinë;
- Është përgjegjës për implementimin e përgjithshëm të masave të sigurisë fizike, sigurisë së personelit, sigurisë kibernetike dhe sigurisë së informacionit të klasifikuar;
- Harton raporte të rregullta mbi gjendjen e sigurisë dhe propozon masa për përmirësim të vazhdueshëm, duke përfshirë rekomandime për ndalimin ose pezullimin e aktiviteteve kur evidentohen shkelje të rënda të kriterëve të sigurisë;
- Bën vlerësimin e riskut të sigurisë dhe zhvillimin e plan-veprimit për menaxhimin e emergjencave, përfshirë përgatitjen për situata të kontaminimit industrial, sabotimeve, apo kërcënimeve hibride;
- Siguron ngritjen dhe zbatimin e mekanizmave për raportimin e incidenteve të sigurisë (fizike apo kibernetike) në AIM dhe në subjektet e licencuara, në përputhje me procedurat e njoftimit dhe ndjekjes së ngjarjeve të sigurisë;
- Mban kontakte periodike dhe informohet nga oficeret e sigurisë së subjekteve të licencuara për çështje që lidhen me sigurinë;
- Propozon drejtorit të Përgjithshëm masa për përmirësimin e gjendjes së sigurisë në AIM dhe të subjekteve të licencuara;
- Ndjek bashkëpunimin dhe koordinon me nivelet teknike të institucioneve të mbrojtjes, ligj zbatuese dhe të inteligjencës për çështje të sigurisë në sektorin e industrisë ushtarake;
- Merr pjesë në inspektime dhe grupe pune me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Sektori i Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a) vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b) vlerësimin kualifikimeve akademike, profesional edhe teknike;
- c) vlerësimin e trajnimeve;
- ç) vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës në rastet e pozicioneve drejtuese;
- d) eksperiencës dhe aftësive drejtuese.

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a) jetëshkrimi, 10 pikë;
- b) arsimimi/kualifikimi, deri 10 pikë;
- c) trajnimi, deri 10 pikë;
- ç) eksperienca/përvoja në punë, deri 10 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.